

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 10 SHKURT 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot diskutojmë një nga ndryshimet më të rëndësishme, që lidhet me një ndryshim në aneksin kushtetues të Kushtetutës, që ka të bëjë me reformën në drejtësi. Reforma në drejtësi u votua në mënyrë unanime më shumë se 5 vjet më parë, me qëllimin e vetëm për t'u kthyer qytetarëve drejtësinë e munguar, një drejtësi të pavarur, të paanshme, të pakapur nga politika dhe të pakorruptuar. Gjatë këtyre viteve të zbatimit të reformës në drejtësi janë arritur rezultate të shumëpritura, si në krijimin e institucioneve, ashtu edhe në veprimtarinë e tyre, rezultate që tashmë janë të njohura dhe njëkohësisht të vlerësuara në të gjitha raportet ndërkombëtare që i adresohen Shqipërisë; në raportet e Këshillit të Europës, në raportet e DASH-it, në raportet e mekanizmave të Këshillit të Europës që monitorojnë Shqipërinë, duke e konsideruar reformën në drejtësi si gur themeli për konsolidimin e shtetit të së drejtës. Rezultatet që janë arritur nga të gjithë aktorët e përfshirë, por me mbështetjen e vazhdueshme dhe që në krye të herës të partnerëve ndërkombëtarë, SHBA-të dhe BE-ja, e kanë konsideruar gjithmonë zbatimin deri në fund të reformës në drejtësi si kartën kryesore të Shqipërisë për rrugëtimin evropian. Jemi të vetëdijshëm që ngritja e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë dhe emërimi i funksionarëve në këto institucione u bë i mundur pasi institucionet e vetingut filluan shqyrtimin dhe vendimmarrjet e para për të gjithë ata që do të emëroheshin në institucionet e reja, duke e konsideruar procesin e vetingut si kyç për ofrimin e garancive për integritetin e tyre. Institucionet e vetingut dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit kanë zhvilluar një proces të jashtëzakonshëm, unik, duke u përballur me vështirësi të herëpashershme, herë për shkak të sfidave mbarëglobale, herë për shkak të sfidës së një eksperience të re dhe një procesi mjaft kompleks dhe herë për shkak të sfidave dhe pengesave të vendosura nga politika.

Nuk duhet të harrojmë se si u pengua zbatimi i ligjit për vetingun për shkak të goditjes së tij në Gjykatën Kushtetuese dhe që pezullimi i tij për disa muaj mbajti peng ngritjen e institucioneve të reja, ashtu siç nuk duhet të harrojmë se si çadra e PD-së në bulevard vonoi ngritjen e organeve të vetingut, të cilat arritën të ngriheshin vetëm 1 vit pas miratimit të ligjit; për të mos folur më pas për të gjitha pengesat e hasura nga moseficienca dhe zvarritja e proceseve të krijuara nga institucione te vjetra të drejtësisë, si Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme, të cilat vonuan me aq sa mundën fillimin e procesit të vetingut. Deri sot jo pak shtete të tjera me problematika në sistemin e drejtësisë kanë qenë të interesuara për procesin e vetingut, me qëllim replikimin e tij, si një proces radikal, i guximshëm, por shumë i rëndësishëm. Jo pa qëllim Komisioni i Venecias, në opinionin përfundimtar të tij në dhjetor të vitit 2016, u shpreh për procesin e vetingut se: "Masa të tilla ishin jo vetëm të justifikuar, por ishin të nevojshme që Shqipëria të mbrohej nga përhapja e korrupsionit, i cili, nëse nuk adresohet, mund të shkatërronte plotësisht sistemin gjyqësor." Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj të datës 18 janar 2017, legjitimoi njëherë e mirë procesin e vetingut, duke e konsideruar ligjin për vetingun në përputhje me Kushtetutën.

Padyshim, reforma në drejtësi është hasur me problematikat e veta në mënyrë të vazhdueshme, për shkak të mentalitetit, për shkak të forcës së zakonit dhe mënyrës se si sistemi ishte mësuar të

funksiononte, për shkak të politikës që nuk lejonte pavarësinë e tij, ashtu si edhe për shkak të korrupsionit të ulur këmbëkryq në sistem. Prandaj, ne mendojmë që reforma në drejtësi është ajo që duhet. Përditë e më shumë unë mendoj që jo vetëm është gjëja më e duhur që kemi bërë, por nga ana tjetër është gjëja e vetme që do t'ju japë qytetarëve shqiptarë një drejtësi të pavarur dhe eficiente. A ka përfunduar zbatimi i reformës në drejtësi? Patjetër që jo! Reforma në drejtësi, si një reformë e thellë, kërkon kohën e saj, por nga ana tjetër kërkon edhe përgjegjësi nga ana e institucioneve të reja të drejtësisë, ashtu siç kërkon edhe mbështetjen nga ana jonë si ligjvënës me përgjegjësi legjitime, sa herë është e nevojshme, në respekt të garancisë së pavarësisë së sistemit. Përgjegjësia jonë politike, por edhe ligjore, është edhe sot për të mbështetur organet e vetingut në dhënien e kohës së nevojshme që të përfundojnë këtë proces kaq të rëndësishëm për të ardhmen e vendit tonë.

Gjithçka fillon nga një sistem drejtësie i pavarur dhe i paanshëm, me magjistratë me integritet që i shërbejnë vetëm ligjit. Procesi i rivlerësimit kalimtar është ideuar si një proces tranzitor, i përkohshëm, i cili, në mënyrë të qëllimshme, është parashikuar në aneksin e Kushtetutës. Bie dakord që Kushtetuta jonë është ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme për çështje të karakterit të ndryshimeve të mëdha, siç janë ndryshimet për sistemet zgjedhore apo parashikime të ndryshme të marrëveshjeve politike, por sot nuk jemi për këtë. Sot po ndryshojmë një nen të aneksit të Kushtetutës për t'i dhënë mbështetje zbatimit të reformës në drejtësi, kohëzgjatjen e organeve të vetingut, një parashikim tërësisht i karakterit teknik. Them "teknik", sepse po u japim mundësinë organeve të vetingut të përfundojnë procesin e rivlerësimit kalimtar edhe për 300 magjistratë të tjerë të mbetur pa kaluar në këtë proces, të miratuar me vullnet të plotë dhe unanim në vitin 2016 nga ky Kuvend. Sot kërkojmë votimin për shtyrjen në kohë të këtij procesi, me qëllim përfundimin tërësor të pastrimit të pallatit të drejtësisë. Zgjatja e mandatit të organeve të vetingut përtej asaj që është konsideruar gjithmonë si një nevojë, e ka zanafillën procedurale nga një kërkesë në shtator të vitit të kaluar nga komiteti drejtues i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, që më pas u përkthye në një iniciativë ligjore nga deputetët e Partisë Socialiste, por që do të ishte e arsyeshme të propozohej edhe nga deputetët e opozitës. Parashikimi i ri për zgjatjen e mandatit të komisioneve të vetingut është në përputhje me të gjitha parimet kushtetuese. Nëpërmjet vijimit të këtij procesi nga komisionet e vetingut garantohej pavarësia dhe paanshmëria e procesit të rivlerësimit. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në janar të vitit 2021, në vendimin "Xhoxhaj kundër Shqipërisë", është shprehur në mbështetje të mënyrës si janë formësuar dhe se si funksionojnë organet e vetingut, duke krijuar të gjitha garancitë për pavarësinë dhe paanshmërinë e vendimmarrjes së këtyre komisioneve.

Ky parashikim i ri kushtetues do të garantojë, gjithashtu, barazinë e procesit dhe garantimin e standardeve të njëjta për subjektet që do të duhet të kalojnë në vijim në këtë proces me të njëjtat organe të vetingut, duke garantuar kështu edhe parimin kushtetues të sigurisë juridike. Ruajtja e eficientës së procesit të vlerësimit, për shkak të një eksperience dhe standardeve të konsoliduara që komisionet e vetingut kanë realizuar, do të krijojë mundësinë që ky proces të përfundojë më shpejt sesa do të përfundonte në rastin e delegimit të këtyre kompetencave në institucione të tjera, ashtu si edhe në rastin e këshillave të sistemit të drejtësisë. Gjatë gjithë kësaj kohe i kemi dëgjuar partnerët tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-në, Mbretërinë e Bashkuar, të cilët kanë qenë të unifikuar në nevojën e këtij ndryshimi kushtetues për shtyrjen e afatit të mandatit të institucioneve të vetingut, me qëllim vazhdimin e këtij procesi, ashtu siç kemi lexuar opinionin e Komisionit të Venecias para dy muajve, i cili e kishte dhënë e zeza në të bardhë miratimin për zgjatjen e afatit të mandatit të organeve të vetingut, pavarësisht se është shprehur shumë herë për këtë proces. Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët konstitucionalistë dhanë mendime të vyera në analizën që paraqitën përpara mbledhjeve të Këshillit të Legjislacionit. Prandaj, të nderuar kolegë, duhet t'ju japim mundësinë këtyre institucioneve të përfundojnë këtë proces, i cili është jo vetëm i domosdoshëm, por edhe jetësor për integritetin e njerëzve që shërbejnë në sistemin e drejtësisë. Faleminderit!